



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË / MINISTARSTVO ZDRAVLJA / MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	01
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	26-10253
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	- 18 -
Data: Datum: Date:	31.12.2024
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministarstvo Zdravstva/Ministry of Health
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

Nr.212/XII/2024

Datë:30.12.2024

Ministri i Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 145, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në përputhje me nenet 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7, 01 Mars 2019), nenit 11 paragrafi 1.5 i Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive Shtojca 1 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1, në bazë të shkresës me nr. prot.05-3817 datë 22.05.2024, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I.** Aprovohet Plani i Veprimit për Fuqizimin dhe Modernizimin e Shërbimit të Trajtimit të Sëmundjes së Epilepsisë me Stimulim të Nervit Vagus (VNS) për Epilepsitë Farmakorezistente.
- II.** Pjesë e këtij Vendimi është „ Plani i Veprimit për Fuqizimin dhe Modernizimin e Shërbimit të Trajtimit të Sëmundjes së Epilepsisë me Stimulim të Nervit Vagus (VNS) për Epilepsitë Farmakorezistente”.
- III.** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Zëvendësministrave;
- Sekretarit të përgjithshëm;
- DPSSH;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MSh-së;

Dr. Arbën Vitia
Ministër i Shëndetësisë



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

**PLANI I VEPRIMIT PËR FUQIZIMIN DHE MODERNIZIMIN E SHËRBIMIT
TË TRAJTIMIT TË SËMUNDJËS SË EPILEPSISË ME STIMULIM TË NERVIT
VAGUS (VNS) PËR EPILEPSITË FARMAKOREZISTENTE**

Prishtinë

2024

PËRMBATJA

1.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE-----	4
2.	HYRJE-----	5
3.	METODOLOGJIA-----	7
4.	SFONDI-----	8
5.	OBJEKTIVAT-----	12
6.	ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT-----	13
7.	NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I PLANIT NACIONAL-----	14
8.	SHTOJCA 1 - PLANI I VEPRIMIT-----	15

SHKURTESAT

VNS	Stimulimi i Nnervit Vagus
EF	Epilepsi Farmakorezistente
MSh	Ministria e Shëndetësisë
KN	Klinika e Neurologjisë
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
ShSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar I Kosovës
AED	Antiepileptik drugs

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Krijimi i shërbimit të ri mjekësor për trajtimin e pacientëve me epilepsi farmakorezistente me metoden e elektrostimulimit të nervit vagus, që ka për qëllim arritjen e një menaxhimi më të mirë të kësaj sëmundje dhe përmirësimin e mirëqenjes së përgjithëshme shëndetësore dhe kualitetit të jetës të pacientëve me epilepsi. Përmes saj, si mund të arrihet kontroll më i mirë i sëmundjes, parandalim, shkurtrim dhe reduktim i krizave epileptike për peridha afatgjatë dhe reduktim i numrit të antiepileptikëve dhe dozave të tyre.

Në Kosovë, fatkeqësisht kemi mungesë të databazës së mirëfilltë me të dhëna të plota për pacientët me epilepsi, numrin e atyre që me vështirësi i kontrollojnë krizat si dhe aktualisht përveq terapisë medikamentoze nuk kemi në dispozicion opsione tjera që përdoren globalisht siç janë kirurgjia e epilepsisë dhe VNS - Vagal Nerve Stimulation.

Plani i veprimit për fuqizimin dhe modernizimin e trajtimit të sëmundjes së epilepsisë me metoden e stimulimit të nervit vagus për epilepsitë farmakorezistente ofron një përmbledhje të veprimeve të nevojshme për t'u ndërmarrë nga institucionet shëndetësore në Kosovë, për të mbledhur të dhëna me qëllim të krijimit të një databaze me të dhëna të sakta prej nga mund të nxjerren edhe raste rezistente. Pastaj identifikimin e nevojave infrastrukturore, teknike dhe burimeve njerëzore, nevojën për trajnime për të mundësuar implementimin e trajtimit të epilepsisë me elektrostimulim të nervit vagus.

Plani synon të arrij avancimin e shërbimit në vend dhe ofrimin e trajtimit bashkëkohorë të pacientëve me epilepsi dhe kjo përmes ofrimit të shërbimeve profesionale nga grupi multidiciplinar për aplikimin e VNS-së ku përfshihet: neurologu, neuropediatri, neurokirurgu, anesteziologu, dhe stafi infermioror të cilët do të kenë mbështetje përmes trajnimeve në ngritjen e kapaciteteve, vizita studimore në këtë lëmi dhe sigurimin e paisjeve të modernizuara për implementimin e trajtimit me VNS.

Qëllimi kryesor i këtij plani është krijimi i këtij shërbimi të trajtimit me elektrostimulim të nervit vagus - VNS, si formë e avancuar dhe një opcion i sigurtë dhe efektiv për ata pacientë të cilët janë me epilepsi refraktare të vërtetuar dhe nuk kanë opsione tjera trajtimi në institucionet tona. Gjithashtu edhe për ata që nuk janë kandidat për trajtim kirurgjik të epilepsisë ose refuzojnë operimin dhe në fund për ata që nuk kanë pasur përmirësim të dukshëm me intervenim operativ të mëhershëm.

2. HYRJE

Rreth 10% e pacientëve me epilepsi nuk mund të menaxhojnë krizat epileptike me medikamente, kurse përafërsisht 1/3 e pacientave me epilepsi nuk janë të mjekuar tërësisht edhe pse përdorin terapi adekuate. Në këto raste në trajtimin bashkëkohorë të epilepsisë janë aprovuar dhe janë në përdorim edhe metoda tjera që janë dëshmuar si më efektive dhe dy prej tyre janë në përdorim me vite, trajtimi kirurgjik i epilepsisë dhe elektrostimulimi i nervit vagus i njohur si Vagal Nerve Stimulation (VNS). Aktualisht objektivi ynë për trajtim sa më efikas të një grupi të pacientëve problematik në aspektin e trajtimit është metoda e elektrostimulimit VNS e cila nënkupton përdorimin e paisjes për detektim të sulmeve që implantohet nën lëkurë në gjoksën e pacientit me anë të së cilës dërgohen sinjale në qendrat adekuate në tru përmes stimulimit të nervit vagus.

Qëllimi i aplikimit të kësaj metode është në uljen e paraqitjes së sulmeve epileptike si dhe uljen e ashpërsisë së sulmeve.

Në SHBA, trajtimi me VNS është aprovuar si terapi shtesë për pacientët më të vjetër se 4 vjeç me sulme me fillim fokal. Ndërsa, në Europë VNS është aprovuar si terapi shtesë për pacientët me epilepsi të gjeneralizuar ose të ata me fillim fokal, pa limit të moshës. Rekomandimet janë që VNS të konsiderohet pas tentimit të mjekimit me së paku dy medikamente antiepileptike të linjës së parë, të administruara sipas protokoleve përkatëse të trajtimit të Epilepsisë, si dhe kur pacienti nuk konsiderohet si i përshtatshëm për trajtim kirurgjikal të epilepsisë.

Trajtim kirurgjik konsiderohet si modalitet me shkallë më të lartë të suksesit të ndërprerjes së krizave epileptike të pacientit me epilepsi refraktare. Por, duke marrë parasysh se në vendin tonë kirurgjia e epilepsisë aktualisht nuk ende nuk funksionin dhe zhvillimi i saj kërkon më tepër kohë dhe përgatitje të ekipës dhe paisjeve, opioni i trajtimit me VNS mund të konsiderohet një alternativë shumë e mirë, më e shpejtë dhe më lehtë e realizueshme. Pacientët të cilët kanë adherencë të dobët ose tolerancë jo të mirë ndaj terapi së antiepileptike (AE) mund të jenë kandidat të përshtatshëm për VNS.

VNS mund të jetë sidomos trajtim i sukseshëm për sindromet epileptike dhe krizat epileptike siç janë Lennox Gestaut sindromi, epilepsia të skleroza tuberose, ataqet absans rezistente dhe krizat atonike. Gjithashtu ka raporte se është e sukseshme edhe të statusi epileptik refraktar dhe super refraktar.

Një meta analizë e 74 studimeve klinike me 3321 pacientë ka treguar se VNS ka rezultuar me reduktim mesatar prej 51% të krizave epileptike pas një viti të aplikimit. Gjithashtu studimet afagjate kanë treguar se efekti i trajtimit me VNS rritet me kalimin e kohës. Për shembull, një studim i cili i ka përcjellur 74 pacient për 10-17 vjet, ka evidentuar reduktim në frekuencën e krizave epileptike për 50-90% në 38.4%, 51.4%, 63.6% dhe 77.8% respektivisht sipas viteve 1-, 2-, 10- dhe 17, tek pacientët e përcjellur pas implantimit të aparatit. VNS gjithashtu zvogëlon edhe frekuencën e vdekjes të pa shpjeguar të përnjëhershme në epilepsi e njohur si SUDEP. Është

e qartë që çdo përmirësim i kontrollimit të krizave epileptike njëkohësisht është edhe përmirësim i mirëqenjes së përgjithëshme shëndetësore dhe kualitetit të jetës.

Një mori prediktorësh të suksesit të kësaj terapie janë identifikuar si: fillimi i epilepsisë mbi moshën 12 vjeçare, tipi i epilepsisë të gjeneralizuar, epilepsia jo lezionale, epilepsia jotraummatike dhe pacientët të cilët kanë histori më të shkurtër se 10 vite të krizave epileptike.

3. METODOLOGJIA

Hartimi i Planit të veprimit për fuqizimin dhe modernizimin e trajtimit të sëmundjës së epilepsisë me stimulimin e nervit vagus për epilepsitë farmakorezistente është realizuar sipas Vendimit Nr: 573/IX/2023 të datës 29.09.2023, e nxjerrur nga Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë. Hartimi i Planit është bazuar në dispozitat e UA 07/2018 për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit.

Plani është hartuar nga grupi punues i emëruar nga Ministria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me profesionistët tjerë të cilët posedojnë njohuri dhe shkathtësi për fushën e caktuar si dhe ekspertizë për hartim të dokumenteve strategjike.

Për përgatitjen e planit janë shqyrtuar të dhëna të bazuara në dëshmi nga raportet e siguruar nga arkiva e Klinikës së Neurologjisë në QKUK, statistikave të OBSH-së, si dhe dokumentet tjera relevante të ndërlidhura me këtë fushë.

Janë konsultuar dokumente të ndryshme relevante vendore dhe ndërkombëtare (si OHCA Guideline, American Association of Neurological Surgeons-VNS, ILAE) me qëllim të përfitimit të njohurive dhe përvojave nga zhvillimet e këtyre shërbimeve, në veçanti në sektorin publik të sistemit shëndetësor.

Grupi hartues, përmes punëtorive dhe takimeve të rregullta, ka analizuar dhe diskutuar sfidat e identifikuara në fushën e trajtimit të EF me VNS, si dhe kanë qartësuar mënyrat për të adresuar këto sfida, me qëllim të përmbushjes së aktiviteteve dhe arritjes së objektivave të përcaktuara.

Dokumenti ka kaluar nëpër fazat e konsultimit të gjerë me profesionistë e lëmive ndërlidhëse, me qëllim të ofrimit të mundësisë për komente profesionale dhe gjithëpërfshirëse gjatë hartimit.

4. SFONDI

Epilepsia është një ndër çrregullimet neurologjike më të shpeshta, e krahasueshme ndoshta vetëm me kokëdhimbjet dhe sëmundjet cerebrovaskulare. Epilepsia është çrregullim kronik neurologjik, i karakterizuar me predispozitën e vazhdueshme të trurit për kriza epileptike të pa provokuara.

Definicioni zyrtar sipas ILAE (International League Against Epilepsy) është që epilepsia paraqet sëmundje të trurit e përcaktuar nga ndonjëri nga kriteret e mëposhtme:

- Të paktën dy kriza epileptike (ose refleksive) të pa provokuara që ndodhin të ndara së paku 24 orë nga njëra-tjetra.
- Një krizë epileptike e paprovokuar (ose refleksive) me një probabilitet për kriza tjera të ngjajshme me rrezikun e rekurences së përgjithshëm (të paktën 60%) që ekziston pas dy krizave të paprovokuara, në periudhën e ardhshme 10 vjeçare.
- Diagnoza e një sindromi epileptik.

Epilepsia mjekohet me medikamente specifike antiepileptike (AE) që sot janë në dispozicion mbi 20 sosh, qoftë në formë monoterapie ose në kombinim të dy apo më tepër medikamenteve.

Sipas statistikave të ShBA, 1.2% e popullatës së saj vuan nga epilepsia aktive. Në Kosovë, fatkeqësisht kemi mungesë të databazës së mirëfilltë me të dhënat e pacientëve me epilepsi, andaj mund të bëjmë vetëm një përlllogaritje të përafërt, krahasuar me numrat botërorë. Kështu, bazuar në numrin zyrtar të Agjencionit të Statistikave, të vitit 2020, numri i gjithmbarshëm i të sëmurëve me epilepsi në Kosovë, do të duhej të ishte 21.600. Nga ky numër 10 % janë me epilepsi refraktare, pra ata që nuk mund të mjekohen me sukses përkundër trajtimit me farmakoterapi aktuale antiepileptike, dmth i bie diku rreth 2160 pacientë.

Numrat janë mjaftë mbresëlënës, por jo edhe trajtimi i tyre në vendin tonë, sidomos krahasuar me vendet e zhvilluara ku ekzistojnë dhe janë duke u hulumtuar një sërë opcionsh te reja dhe mjaft shpresëdhënëse për këta pacientë.

Rreth 1/3 e gjithë pacientëve me epilepsi, kanë epilepsi të patrajtueshme, e ashtuquajtura epilepsi refraktare. Me fjalë tjera, këta pacientë janë pa kurrfarë përgjigje terapeutike ndaj 2-3 llojeve të terapisë antiepileptike që e marrin rregullisht. Kjo si pasojë ka efekt fundamental dhe shkatërrues në jetën apo thënë më mirë në funksionalitetin e tyre të përditshëm.


Sot kemi modalitete jo-farmakologjike të trajtimit, të cilat përfshijnë parasëgjithash mjekimin kirurgjik të epilepsive, modalitetet metabolike (dietën ketogjene etj) dhe neurostimulimin.

VNS (stimulimi i nervit vagal) ka filluar të aplikohet për herë të parë para 25 vitesh, ku implantimi i parë në pacient është bërë në vitin 1988. Bashkësia Europiane e ka aprovuar për përdorim në vitin 1994, kurse FDA Amerikane ka dhënë pëlqimin e saj për VNS në vitin 1997. VNS është aprovuar si terapi shtesë e krizave epileptike refraktare me fillim fokal, te të rriturit dhe fëmijët mbi moshën 12 vjeçare. Përafërsisht 30-40% e këtyre pacientëve kanë reduktim më të madh se 50% në frekuencën e krizave epileptike dhe ky përmirësim është afatgjatë.

VNS është një opcion relativisht i sigurtë dhe valid për ata pacientë të cilët janë me epilepsi refraktare të vërtetuar, të cilët ose nuk janë kandidat për mjekim kirurgjik të epilepsisë ose refuzojnë operimin dhe në fund për ata që nuk kanë pasur përmirësim të dukshëm me intervenim operativ të mëhershëm. VNS implantohet për reduktim të shpeshtësisë dhe ashpërsisë së krizave epileptike. VNS mundet gjithashtu të shfrytëzohet si ekstra stimulim në fillim të krizës epileptike, që te një grup pacientësh paraqet një benefit shtesë. VNS ka efekt si në shkurtimin apo ndërprerjen e krizës akute epileptike, poashtu edhe në parandalimin dhe rrallimin e krizave, pra ka veprim afatgjatë.

Të dhënat teknike për implantimin e VNS

1. **Implantimi i pajisjes:** Një pajisje e vogël, e ngjashme me një pacemaker që faktikisht paraqet një puls gjenerator me bateri i cili implantohet kirurgjikisht nën lëkurë në anën e majtë të gjoksit. Kjo pajisje është e lidhur përmes një teli përques që vendoset nën lëkur me elektrodën që mbështjelljet rreth nervit të majtë vagus në regjionin e qafës.
2. **Stimulimi:** Pajisja jep impuls elektrik të rregullt në nervin vagus përmes të cilit pastaj impulset përcjellen në nivelet më të larta të trurit. Frekuenca dhe intensiteti i këtyre impulseve zakonisht programohet dhe kontrollohen me një pajisje të veçantë nga një specialist neurolog.
3. **Ndikimi në tru:** Nervi vagus është i përfshirë në rregullimin e shumë funksioneve të trupit, duke përfshirë edhe ato vitale kardiovaskulare dhe respiratore e digjesitve. Stimulimi i nervit vagus mund të ndikojë në aktivitetin e disa zonave të trurit, si sistemi limbik, i cili është i përfshirë në emocione dhe krizat epileptike.
4. **Efektet:** Në epilepsi, besohet që VNS ndihmon në reduktimin e frekuencës dhe ashpërsisë së krizave epileptike, megjithatë, mekanizmi i saktë nuk është plotësisht i kuptueshëm. Në depresion, VNS mund të ndihmojë në rregullimin e humorit duke ndikuar në lirimin e neurotransmiterëve si serotonina dhe norepinefrina.
5. **Rregullimet:** Parametrat e pajisjes VNS mund të rregullohen me kalimin e kohës për të optimizuar efektivitetin e saj. Pacientët gjithashtu mund të marrin një magnet portativ që ata mund ta përdorin për të aktivizuar manualisht pajisjen nëse ndiejnë një krizë që po vjen, e gjithashtu ta kontrollojnë sipas nevojës në ON/OFF.



I. Indikacionet për VNS janë të qarta dhe përfshijnë:

A. Krizat epileptike me fillim fokal, refraktare në terapi antiepileptike.

- a. Kriza refraktare nënkupton krizë që ndodh edhe përkundër përdorimit të dozave terapeutike të AED, ose kriza që nuk mund të trajtohen me nivele terapeutike të barnave antiepileptike për shkak të efekteve anësore të padëshiruara.
- b. Pacienti ka dështuar ose nuk është i përshtatshëm për trajtim kirurgjikal.
- c. Të paktën 2 kriza komplekse parciale në muaj ose status epileptik rekurent që rrezikon jetën.
- d. Pasi të janë provuar të paktën 3 barna antiepileptike të linjës së parë në një periudhë të paktën 2 vjeçare

B. Krizat e gjeneralizuara refraktare në terapi antiepileptike

- a. Kriza refraktare të gjeneralizuara nënkupton krizat që ndodhin edhe përkundër përdorimit të dozave terapeutike të AED, ose krizat që nuk mund të trajtohen me nivele terapeutike të barnave antiepileptike për shkak të efekteve anësore të padëshiruara.
- b. Pacienti ka dështuar në trajtim ose nuk është i përshtatshëm për trajtim kirurgjikal
- c. Të paktën 1 krizë e gjeneralizuar në muaj ose statuse epileptik rekurent që rrezikon jetën
- d. Pasi të janë provuar të paktën 3 barna antiepileptike të linjës së parë në një periudhë të paktën 2 vjeçare

II. Kriteret përjashtuese

Kriteret e mëposhtme do të përjashtojnë një pacient nga trajtimi me VNS:

- a. Krizat tjera që janë të pa sqaruara dhe të paqarta pra që nuk janë me fillim fokal ose nuk janë kriza të gjeneralizuar refraktare në terapi AE.
- b. Pacientët që mund të trajtohen me sukses me barna antiepileptike dhe/ose dieta ketogjenike
- c. Pacientët me probleme kardiake – aritmi dhe çrregullime konduktive
- d. Pacientët me çrregullime psikiatrike – çrregullim psikotik, bipolar
- e. Pacientët me probleme kognitive që mund të mos jenë në gjendje të kenë benefit nga trajtimi dhe nuk do të jenë në gjendje të përcjellin protokolet e trajtimit dhe ndryshimet në frekuencen dhe llojin e krizave
- f. **Pacientët me abnormalitet të nervit vagus:** Rrallë, individët mund të kenë një abnormalitet anatomo-funksional të nervit vagus që mund ta bëjë VNS më pak efektive ose të rrezikshme.
- g. **Fëmijët nën moshën 4 vjeç:** VNS zakonisht nuk rekomandohet për fëmijët nën moshën 4 vjeç, pasi siguria dhe efektiviteti i saj në këtë grupmoshë nuk është përcaktuar mirë.
- h. Pacientët me tremor esenciale të izoluar
- i. Pacientë me implante të pacemakerit kardiak dhe implante tjera metalike
- j. Shtatzania

5. OBJEKTIVAT

Plani i veprimit për fuqizimin dhe modernizimin e shërbimit të trajtimit të sëmundjës së epilepsisë me stimulim të nervit vagus (VNS) për epilepsitë farmakorezistente, synohet të zbatohet përmes:

Objektivi Strategjik

- Fuqizimi dhe modernizimi i shërbimit të trajtimit të sëmundjës së epilepsisë me stimulim të nervit vagus (VNS) për epilepsitë farmakorezistente.

Objektiva specifike

- Krijimi i grupit multidisiplinar si dhe trajnimi i tij për aplikimin e VNS-së
- Implementimi i trajtimit me VNS-së të pacientet me epilepsi farmakoresistente

Këto objektiva synohen të zbatohen përmes aktiviteteve si në vijim:

1. Formimi i grupit multidisiplinar për aplikimin e VNS-së.
2. Trajnimi për aplikimin, monitorimin dhe kalibrimin e pajisjes së VNS-së
3. Identifikimi i pacientëve me epilepsi farmakorezistente që plotësojnë kriteret për aplikim të VNS-së.
4. Sigurimi i pajisjes së VNS-së.
5. Implementimi i trajtimit me VNS-së në bashkëpunim dhe mbështetje nga një qendër që ka përvojë në implementimin e kësaj terapie.

6. ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT

Realizimi i aktiviteteve për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Planit të veprimit për fuqizimin dhe modernizimin e shërbimit të trajtimit të sëmundjës së epilepsisë me stimulim të nervit vagus (VNS) për epilepsinë farmakorezistente, do të mundësojnë sigurimin e të dhënave të bazuara në dëshmi lidhur me arritjen e objektivave të përcaktuara në këtë dokument. Qëllimi i monitorimit është ofrimi i raporteve lidhur me zbatimin e Planit të veprimit, sipas të dhënave zyrtare, të cilat do të shërbejnë për vendime të bazuara në dëshmi për MSh-në.

Bazuar në indikatorët kyç të definuar në Plan të veprimit, monitorohen indikatorët sipas periudhës dhe frekuencës së përcaktuar dhe raportohen në MSh duke siguruar që institucionet shëndetësore dhe departamentet përgjegjëse të ofrojnë llogaridhënie në rast të moszbatimit të detyrave dhe aktiviteteve të planifikuara.

Ky proces do të ndikoj në ndryshimin dhe plotësimin vjetor të Planit të Veprimit. Parim udhëheqës gjatë procesit të monitorimit dhe vlerësimit është gjithëpërfshirja, ku në proces të monitorimit dhe vlerësimit do të përfshihen të gjithë akterët dhe institucionet hisedare në këtë fushë përmes shfrytëzimit të kapaciteteve institucionale, procedurave të brendshme dhe mekanizmave tjerë administrativë që lidhin dhe mundësojnë komunikimin e institucioneve shëndetësore mes vete. Në këtë proces, theksi është vënë në përdorimin e mekanizmave ekzistues për mbledhjen, agregimin, analizën dhe diseminimin e të dhënave në kuadër të Ministrisë dhe institucioneve tjera të përfshira. Ky dokument përfshin një numër të indikatorëve në nivele të ndryshme të zbatimit për periudhën kohore të përcaktuar në dokument, duke shfrytëzuar burime të informatave, raportime në periudha të rregullta përmes strukturave të përcaktuara të procesit të monitorimit.

Raportimi i zbatimit të aktiviteteve, sfidave eventuale dhe rekomandimet për ndryshime do të jetë periodik dhe me kohë. Kjo do të mundësojë adresimin në kohën e duhur që ka për qëllim orientimin e politikave për shërbimet mjekësore të sëmundjës së epilepsisë me stimulimin e nervit vagus për epilepsinë farmakorezistente. Rezultatet e pritura nga procesi i monitorimit dhe vlerësimit do të mundësojnë edhe ofrimin e informatave kthyesë efektive dhe me kohë për të gjitha grupet e interesit, ofrimin e raporteve të performancës së tyre, raportet fillestare ku janë të përcaktuara vlerat bazë të treguesve krahasuar me vlerat e pritshme dhe të dëshirueshme, raportet periodike të progresit si dhe raportet vjetore të performancës.

Vlerësimi përfundimtar i dokumentit do të ofroj të dhëna të bazuara në dëshmi të cilat do të shfrytëzohen si bazë për përcaktimin e kahjeve strategjike në periudhat e ardhshme si dhe hartimin e dokumenteve tjera në vazhdimësi. Raporti i monitorimit të progresit, zbatimit dhe arritjeve të planit të veprimit do t'i prezantohet të gjitha institucioneve hisedare si dhe instancave përkatëse në baza të rregullta dhe kur është e nevojshme edhe publikut.

7. NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I PLANI

Burime të financimit për realizim të aktiviteteve nga Plani do të shfrytëzohen nga buxheti i Republikës së Kosovës, i ndarë për institucionet mbikëqyrëse dhe zbatuese, ndërkohë që një pjesë e tyre do të mbështeten edhe nga partnerët strategjikë dhe kontribuesit në sektorin e shëndetësisë.

PLANI I VEPRIMIT

PLANI I VEPRIMIT PËR FUQIZIMIN DHE MODERNIZIMIN E SHËRBIMIT TË TRAJTIMIT TË SËMUNDJËS SË EPILEPSISË ME STIMULIM TË NERVIT VAGUS (VNS) PËR EPILEPSITË FARMAKOREZISTENTE								
OBJEKTIVA STRATEGJIKE: Fuqizimi dhe modernizimin e shërbimit të trajtimit të sëmundjës së epilepsisë me stimulim të nervit vagus (VNS) për epilepsitë farmakorezistente								
Objektiva specifike 1	Indikatori (ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza 2024	Caku 2025	Caku 2026				
Ofrimi i shërbimeve profesionale përmes grupit multidiciplinar për aplikimin e VNS-së dhe trajnimi i tij (ku përfshihet neurologu, neuropediatri, neurokirurgu, anesteziologu dhe stafi infermioror).	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i pacientëve me epilepsi farmakoresistente që trajtohen me VNS - Numri i krizave epileptike të reduktuara pas trajtimit me VNS - Numri i krizave epileptike të evidentuara me aparaturën e VNS dhe numri i parandalimit klinike të tyre. - Reduktimi dozës dhe numrit të antikonvulzive të pacientet me eplepsi farmakoresistente. - Reduktimi i hospitizimeve të pacientët me epilepsi farmakorezistente, të trajtuar me VNS. 	%	%	%				
Aktiviteti	Afati i zbatimit	Kostoja totale			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucionet mbështetëse	Produkti
		2024	2025	2026				
1.1 Trajimi i grupit multidisiplinar për aplikimin	2024	2000€	2000€	2000€	MSH,	KN	MSH	neurologu, neuropediatri,

e VNS-së.					SHSKUK	QKUK SHSKUK	SHSKUK Donatorët	neurokirurgu, anesteziologu, dhe stafi infirmieror
1.2 Hulumtimi dhe identifikimi i pacientëve me epilepsi farmakorezistente	2024-2025	0€	0€	0€	SHSKUK	KN QKUK	MSH SHSKUK Donatorët	Klinika e neurologjisë dhe repartet e neurologjisë në spitalet e pergjithshme
1.3 Pajisjet VNS-se	2024-2025	90000€	90000€	90000€	SHSKUK	KN QKUK	MSH SHSKUK Donatorët	Elektroda, bateria (longlife), softwer, gjeneratori i pulsit.
1.4 Servisimi dhe mirëmbajtja e të gjitha pajisjeve për kryerjen e shërbimit për trajtim me VNS	2024-2025	0€	0€	0€		KN QKUK	MSH SHSKUK Donatorët	Servisimi dhe mirëmbajtja e rregulltë në vazhdimësi nga operatori ekonomik i licencuar
1.5. Trajnimi i vazhdueshëmi i stafit me mbështetje të Qendrave që kanë përvojë.	2024-2025	0€	0€	0€	SHSKUK Odat	SHSKUK	Msh Odat	3 neurolog, 2 neurokirurg, 1 anesteziolog.

					Donatorët		Donatorët	
1.6 Këshillimi i pacientëve dhe familjarëve për procedurën e vendosjes dhe mirembajtjes së trajtimit me VNS	2024-2025	500€	500€	500€	SHSKUK Odat Donatorët	KN QKUK	Msh Odat Donatorët	Neurologët dhe infermierët e neurologjisë
	2024-2025				SHSKUK Odat Donatorët	KN QKUK	Msh Odat Donatorët	
	Totali	93500€	93500€	93500€			Totali	280500€